

# RAPORTI

---

Monitorimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, viti 2019.  
Subjekti zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Ekspert Financiar/Auditues ligjor**  
**Sherife Hoxha**

## Tabelë Përmbledhje

I. Informacion i Përgjithshëm.....	2
A. Informacion ligjor.....	2
i. Kuadri ligjor .....	2
a. Kohëzgjatja e misionit.....	2
b. Fushëveprimi i monitorimit .....	2
ii. Kontrata e shërbimit .....	3
iii. Vendimi i KQZ-së .....	4
iv. Përgjegjësitë respektive të palëve, subjektit zgjedhor “Partia socialiste e Shqipërisë” dhe ekspertës financiare Sherife Hoxha. ....	4
B. Paraqitja e raportit të monitorimit dhe struktura e tij. ....	5
i. Prezantimi i subjektit zgjedhor.....	5
ii. Struktura dhe objekti i raportit të monitorimit.....	6
a. Zyrat zgjedhore.....	6
a.1 Zyrat elektorale .....	6
a.2. Kostimi i zyrave elektorale .....	10
b. Aktivitetet, eventet dhe materialet e fushatës .....	14
c. Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor .....	25
iii. Komunikimet e ekspertit financiar me subjektin zgjedhor dhe palët e treta. ....	28
II Përmbledhje/Kërkesat formale.....	32
A. Përmbledhje.....	32
B. Analiza .....	33
a. Kërkesat formale .....	33
Shënime :.....	38

## I. Informacion i Përgjithshëm

### A. Informacion ligjor

#### i. Kuadri ligjor

Monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore, për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, u krye duke u mbështetur në:

- Ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008, Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kreu II pjesa II me ndryshimet e mëvonshme
- Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017
- Aktet nënligjore të KQZ :
- Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe aktet ligjore të mëvonshme.
- Udhëzimi Nr. 1, datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore të partive politike", i ndryshuar me vendimin nr.153 datë 11.04.2019.
- Udhëzimit të KQZ-së nr.2, datë 01.06.2017, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës zgjedhore" dhe standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit të parashikuara në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
- Udhëzimin Nr.3 datë 2.06.2017 "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".

#### a. Kohëzgjatja e misionit

- Periudha që përfshin raporti i monitorimit është 3 muaj para dhe pas datës së zgjedhjeve nga 30.03.2019 deri më 30.09.2019, sipas udhëzimit nr.2 datë 01.06.2017, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiarë", neni 3, gërma f, "transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike". Afati i përgatitjes së dorëzimit të raportit përfundimtar të monitorimit 4 muaj pas datës së shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

#### b. Fushëveprimi i monitorimit

## Monitorimi u krye :

- me synim vlerësimin për shkallën e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjektit zgjedhor me kushtet dhe kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, për financimin dhe raportimin e shpenzimeve financiare përfituar nga partia politike gjatë fushatës.
- në zbatim të Udhëzimi Nr. 1, datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore të partive politike", i ndryshuar me vendimin nr 153 datë 11.04.2019.
- në zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
- në dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor.
- mbi respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive.
- në kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit.
- në zbatim të rregullave të brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve.
- mbi transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.
- me anë të vëzhgimit në terren, inspektimit, verifikimit, konfirmimit dhe grumbullimit të informacionit për veprimtari dhe aktivitete të subjektit zgjedhor të përzgjedhura në mënyrë statistikore. Mbas grumbullimit të informacionit, mbështetur në Udhëzimin nr.3 datë 02.06.2017, "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore", u llogaritën shpenzimet për zyrat elektorale si : shpenzime qeraje, tatimi në burim, shpenzimet për aktivitetet si dhe shpenzimet e materialeve promocionale të përdorura në fushatën zgjedhore 2019.

## ii. Kontrata e shërbimit

Raporti për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, u hartua bazuar në kontratën e shërbimit nr. 5052 prot. datë 01.06.2019 duke përfshirë monitorimin për aktivitete, veprimtaritë dhe materiale të përdorura nga subjekti zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale, si dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në këtë kontratë, në përputhje me Kodin Zgjedhor, ligjin nr 8580, datë 17.02.2000. "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr 90/2017, dhe aktet nënligjore të KQZ të miratuara për këtë qëllim.

### iii. Vendimi i KQZ-së

Gjithashu raporti për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore u hartua bazuar në Vendimin nr. 740 datë 31.05.2019, "Për shpalljen e rezultatit të shortit, për emërimin e ekspertëve financiar dhe audituesve ligjor të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019".

### iv. Pergjegjësiti respektive të palëve, subjektit zgjedhor "Partia socialiste e Shqipërisë" dhe ekspertës financiare Sherife Hoxha.

Nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" duhet :

Të vihet në dipozicion të ekspertit financiar cdo informacion, dokumentat e disponuara, apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas nenit 91, pika 2, të kodit zgjedhor si:

- Dokumentat bazë kontabël dhe informacion e duhur.
- Listën e aktiviteteve elektorale, datën, vendin dhe orën e organizimit.
- Listën përmbledhese me të gjitha zyrat elektorale dhe vendodhjet e tyre, kontratat e qerave, kontratat e huapërdorjeve dhe cdo document tjetër i fushatës zgjedhore.
- Deklaratat e dhuruesve.
- Dokumentat që përcaktojnë identitetin e dhuruesve.
- Dokumentacionin justifikues të shpenzimeve si: faturat fiskale, kontrata apo marrëveshje etj.
- Pasqyrat për llogari bankare të fushatës të subjektit zgjedhor dhe të llogarive të tjera që janë kryer shpenzime dhe të ardhura në funksion të fushatës zgjedhore.
- Çdo dokument tjetër që është në funksion të fushates zgjedhore
- Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet që janë të nevojshme për arritjen e qëllimit të monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

Ekspertja financiare do të monitorojë në mënyrë specifike:

- Aktivitetet, zyrat elektorale, me anë të vëzhgimit në terren, grumbullimit të informacionit për veprimtari të përzgjedhura në mënyrë statistikore. Mbas grumbullimit të informacionit, mbështetur në Udhëzimin nr.3 datë 02.06.2017, "Për përlllogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore", do të llogariten shpenzimet e fushatës zgjedhore të 30.06.2019.
- Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë Politike" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;
- Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;

- Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruar nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

Eksperti financiar, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontarte nuk duhet të bëjë publike asnjë informacion konfidencial, që ka të bëjë me partinë politike.

Në përfundim ne do të paraqesim një raport për KQZ-në.

## B. Paraqitja e raportit të monitorimit dhe struktura e tij.

### i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia Socialiste e Shqipërisë sipas dokumentacionit të zyrës së rregjistrimit të partive politike, rezulton e rregjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , me urdhër nr. 36/1 datë 15.08.1991, të Ministrit të Drejtësisë. Emri i plotë i partisë është **“Partia Socialiste e Shqipërisë”** me initiale **“PS”**, të cilat përdoren në dokumentat zyrtare të partisë. Kryetar i partisë është z. Edi Rama. Në organet tatimore është rregjistruar me NIPT K713290002F.

Partia Socialiste e Shqipërisë është një parti politike, që e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, konkretisht:

- Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017
- Ligji nr 1019 datë 29/12/2018 dhe ndryshuar me ligjin nr 74/2012, datë 19/07/2012 dhe ligjin nr 31/2018, datë 02.04.2015 “Kodin Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”
- Ligjin nr.8788 datë 07.05.2001 “Për Rregjistrimin e Organizatave Jofitimpruesë”
- Akte nënligjore

Ajo është bashkim vullnetar i shtetasve shqiptarë mbi bazën e ideve, bindjeve, të pikepamjeve dhe të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit, nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqesimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.

Sipas regjistrimit të KQZ-së rezultoi se: subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar në KQZ me nr. prot 36 , më datë 08.04.2019, **me adresë të Selisë qendrore në Sheshin “Austria” nr 91, Tiranë.**

Kryetar i partisë është Z. Edi Rama dhe Financiere Znj. Dhurata Isufaj dhe PS shtrin veprimtarinë e saj në të gjitha rrethet e Shqipërisë. Organizimi i saj është në nivel vendor dhe qendror. Partia Socialiste

e Shqipërisë ka shpallur kandidatet për kryetar bashkie në zgjedhjet vendore 2019, në 60 bashkitë e vendit.

## ii. Struktura dhe objekti i raportit të monitorimit.

### a. Zyrrat zgjedhore

#### a.1 Zyrrat elektorale

Pas marrjes së misionit të monitorimit, komunikua me përfaqësuesit e subjektit zgjedhor për të marrë informacionin në lidhje me numrin dhe adresat e zyrrave zgjedhore. Gjatë javës së parë të monitorimit (referuar raportit të ndërmjetëm të javës së parë), zyrrat zgjedhore ishin në procesin e fillimeve për hapjen e tyre. Listat e zyrrave elektorale ishin në përgatitje dhe na u vunë në dispozicion në javët në vijim të fushatës.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë, 31.05.2017, “Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” neni 2 pika 3, “subjekti zgjedhor është i detyruar që brenda 5 ditëve të njoftojë me shkrim Kryetarin e bashkisë përkthëse, për adresat e sakta të zyrrave elektorale. Ne jemi drejtuar bashkive me një kërkesë për të na informuar në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi, nga subjekti zgjedhor. Më poshtë po paraqesim tabelën përmbledhëse të informacionit të marrë nga bashkitë dhe subjekti zgjedhor për zyrrat elektorale.

Nr	Qarku	Bashkia	Përgjigjet nga Bashkia për zyrrat zgjedhore	Nr i zyrrave të konfirmuara nga Bashkia	Informacioni për zyrrat nga Partia	Zyrrat e monitoruara sipas bashkive
1	Shkodër	Malësi e Madhe	Pa përgjigje		Nuk ka informacion	0
2		Shkodër	PS nuk ka bërë kërkesë		Nuk ka informacion	3
3		Vau Dejës	PS nuk ka njoftuar		Nuk ka informacion	0
4		Pukë	Pa përgjigje		Nuk ka informacion	0
5		Fushë-Arrëz		1	1	1
6	Kukës	Tropojë	PS nuk ka njoftuar		1	1
7		Has		1	1	1
8		Kukës	Pa përgjigje		1	1
9	Lezhë	Lezhë	Pa përgjigje		2	1
10		Mirditë		2	2	0
11		Kurbin		2	2	0
12	Dibër	Mat	Pa përgjigje		1	1
13		Klos		1	1	1
14		Bulqizë	Pa përgjigje		1	0
15		Dibër	Pa përgjigje		1	0
16	Durrës	Krujë		2	2	2
17		Durrës	Pa përgjigje		29	5
18		Shijak		2	2	2
19	Tiranë	Vorë	Pa përgjigje		2	2
20		Kamëz	Pa përgjigje		2	2

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

21		Tiranë		81	81	16
22		Kavajë		10	2	1
23		Rrogozhinë	Pa përgjigje		1	1
24	Elbasan	Peqin	Pa përgjigje		1	2
25		Belsh		1	1	1
26		Cërrik	Pa përgjigje		1	1
27		Elbasan		6	6	7
28		Gramsh		1	1	1
29		Librazhd	Pa përgjigje		4	2
30		Prrenjas		2	2	2
31		Fier	Lushnjë		21	21
32	Divjakë			5	5	0
33	Fier			1	1	1
34	Patos			1	1	1
35	Roskovec			5	5	2
36	Mallakastër		Nuk ka njoftuar		0	0
37	Berat	Ura vajgurore		1	1	1
38		Kucovë		1	1	1
39		Berat	Pa përgjigje			7
40		Polican	PS nuk ka zyra elektorale		0	0
41		Skrapar	PS nuk ka deklaruar zyra		0	0
42	Korçë	Pogradec		5		3
43		Maliq	Pa përgjigje			1
44		Pustec		1	1	1
45		Devoll	PS nuk ka njoftuar			0
46		Korçë		9	9	4
47		Kolonjë		2	2	1
48	Gjirokastrë	Përmet	Pa përgjigje		1	1
49		Kelcyrë		1	1	1
50		Memaliaj		1	1	1
51		Tepelenë	PS nuk ka njoftuar		1	1
52		Gjirokastrë	PS nuk ka njoftuar		4	2
53		Libohovë	Pa përgjigje		1	1
54		Dropull		1	1	1
55		Vlorë	Vlorë		10	10
56	Selenicë		Pa përgjigje		1	1
57	Himarë			1	1	1
58	Delvinë		PS nuk ka njoftuar		0	0
59	Sarandë		Pa përgjigje		2	2
60	Konispol			1	1	0
				179	223	101

Duke shqyrtuar të dhënat sipas tabelës, rezulton se :

- nga 60 Bashki, 40 prej tyre (ose rreth 66.67 % ) i janë përgjigjur kërkesës sonë për hapjen e zyrave elektorale.
- 20 Bashki, (ose rreth 33.33 % ) prej tyre nuk i janë përgjigjur kërkesës sonë për numurin dhe adresat e sakta të zyrave elektorale.

Janë monitoruar rreth 101 zyra, ose 45% e zyrave të deklaruara të hapura nga informacioni i grumbulluar nga partia.



Referuar të dhënave sipas tabelës për 20 bashkitë që nuk iu përgjigjën kërkesës sonë, ne monitoruam për grumbullimin e informacionit, por kishim vështirësi në identifikimin e zyrave elektorale, pasi në shumicën e rasteve nuk ishin të dallueshme dhe bëheshin funksionale mbas orës 17:00.

Në vazhdim të punës, për të gjitha zyrat e monitoruara, janë plotësuar formularët përkatës, (paraqitur në raportet javore të ndërmjetme të monitorimit), me përjashtim të rasteve kur këto zyra janë gjetur të mbyllura. Këto janë paraqitur në raportet javore të ndërmjetme gjatë muajit Qershor 2019.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë, 31.05.2017, “Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” neni 2 pika 1, nuk u identifikuan raste të përdorimit dhe afishimit të materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.

Për zbatimin e udhëzimit nr, 1 datë , 31.05.2017 “Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” pikërisht neni 2, pika 2, për numrin maksimal të zyrave të lejuara (jo më shumë se 1 zyrë për lagje qyteti ose fshat), duhet t'i referohemi popullsisë sipas bashkive. Referuar ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 6, pika 3 “Një, lagje si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë”. Por nuk ka informacion zyrtar për ndarjen territoriale sipas bashkive. Nga informacioni i kërkuar ne faqen zyrtare, INSTAT nuk ka të shpallur numrin e popullsisë sipas bashkive, por vetëm sipas qarqeve.

Ne ju drejtuam me një kërkesë zyrtare me postë, disa bashkive që kanë numrin më të madh të zyrave elektorale, për të na qartësuar në lidhje me numrin e lagjeve sipas qyteteve. Konkretisht për qytetet Tiranë, Durrës, Lushnjë, Vlorë, Pogradec, Roskovec, Korçë etj. Nga përgjigjet që ne kemi marrë bashkitë janë të organizuara në njësi administrative dhe cdo njësi ka një ose më shumë se një lagje. Për bashkinë **Vlorë** referuar edhe përgjigjes së bashkisë, nuk ka raste, që në një lagje të ketë më shumë se një zyrë elektorale.

Për bashkinë **Lushnjë** sipas konfirmimeve ka 5 njësi administrative. Çdo njësi ka dy lagje, pra gjithsej 10 lagje. Në këtë bashki në lagjen “Xhevdet Nepravishta” të njësisë nr. 2 ka 2 zyra elektorale.

Bashkia **Roskovec** në përgjigjen e kthyer, konfirmon se: “Pas hyrjes ne fuqin të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Këshilli i Bashkisë Roskovec, nuk ka marrë vendim për ndarjen e qytetit Roskovec në nëndarje/lagje, pasi numri i banorëve të qytetit është më i ulët se limiti ligjor, prej 20 mijë banorë për krijimin e një lagjeje”. Numri i zyrave të hapura në këtë bashki është 4 zyra zgjedhore.

Bashkia **Durrës** nuk iu përgjigj shkresës tonë për numrin e lagjeve në qytetin e Durrësit.

Nga përgjigjet e bashkive të marra për numrin e zyrave elektorale, ne identifikuam se në këto bashki, nuk është zbatuar udhëzimi nr. 1 datë, 31.05.2017 “Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” pikërisht neni 2, pika 2, “Për numrin maksimal të zyrave të lejuara (jo më shumë se 1 zyrë për lagje qyteti ose fshat). **Mungesa e informacionit në faqen zyrtare INSTAT, dhe informacionet jo të qarta në ndarjet territoriale (lagje), të këtyre bashkive e vështirëson gjykimin tonë, nëse do ti konsiderojmë shkelje ligjore.**

Bazuar në informacionin e dhënë nga Partia dhe e konfirmuar nga disa bashki, po paraqesim disa nga **parregullsitë në lidhje me numrin e zyrave elektorale.**

### Në bashkinë Durrës

#### 1. Në lagjen nr. 17, janë hapur 4 zyra elektorale,

- 1 zyrë në adresën : Rruga "Drenica" lokal Përmeti.
- 1 zyrë pranë shkollës së Re Kënetë
- 1 zyrë elektorale, pranë zjarrfikësit
- 1 zyrë elektorale në rrugën "Dalip Peza"

#### 2 Në lagjen nr. 13 janë hapur 3 zyra elektorale

- 1 zyre në plazh pranë karburantit Gega, sip 47 m2
- 2 zyra në rrugën "Pavarësia" Plazh/13 dhe Komunalja plazh.

#### 3. Në lagjen nr. 14 janë hapur 4 zyra elektorale

- 1 zyrë në lagjen 14 Pallati i Ri,
- 1 zyrë në rrugën "Vath Truja" Nish-tulla, afër tregut,
- 1 zyrë në rrugën "Divjaka" përballë Drejtorisë së AKU,
- 1 zyrë përballë shkollës "Olsi Nako " kati i dytë.

#### 4. Në lagjen nr. 15 janë 3 zyra elektorale

- 1 zyrë në rr "Aleksandër Goga"përballë varrezave te vjetra.
- 1 zyrë në rr "Aleksandër Goga" Spitali.
- 1 zyrë në rr "Aleksandër Goga", përballë shkollës "Met Hasa".

5. Në bashkinë **Lushnjë**, në njësinë administrative nr. 2, e cila ka dy 2 lagje "Kongresi" dhe "Xhevdet Nepravishta" (konfirmuar edhe nga bashkia Lushnjë sipas shkresës me nr. prot 9343 datë, 05.11.2019), nuk është zbatuar udhëzimi nr. 1 datë 31.05.2017, neni 2, pika 2. Në këtë njësi janë hapur 3 zyra elektorale, por ( 2 zyra janë në një lagje) konkretisht:

- 1 zyrë në lagjen "Xhevdet Nepravishta", lokali i Shpresa Pupi, kati i parë, pranë zjarrfikses.
- 1 zyrë në lagjen "Xhevdet Nepravishta", lokali i Maqo Bixheku, rruga Qerim Arapi.

6. Për bashkinë **Gjirokastrë**, sipas informacioneve të PS, janë hapur 4 zyra elektorale. Pas verifikimit te dokumentave pranë subjektit zgjedhor, janë 7 kontrata qiraje për zyra elektorale.

Në pergjigjen e kthyer nga bashkia na u komunikua se PS nuk ka njoftuar për hapjen e këtyre zyrave elektorale.

7. Nuk i janë përgjigjur korrespondencës apo kërkesave dhe informacioneve tona, si me email ashtu edhe me telefon, kryetarët e Partisë Socialiste dhe kandidatët për kryetar bashkie në bashkitë **Lushnjë, Durrës dhe Gjirokastrë**, për verifikimin e informacioneve të kërkuara në lidhje me zyrat zgjedhore.

## a.2. Kostimi i zyrave elektorale

Partia Socialiste e Shqipërisë, për zyrat elektorale të hapura, ka lidhur kontrata qiraje dhe kontrata huapërdorje.

Për kontratat e qirave, kemi verifikuar çmimin e vendosur në kontratë, duke e krahasuar vlerën e qirasë me vlerën e përcaktuar në udhëzimin nr. 3 datë, 28.12.2016, të Entit të Banesave “kostot mesatare të banesave për vitin 2016” si dhe në VKM nr. 469 datë. 03.05.2015. “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave për qëllime tatimore”. Në të gjitha rastet, kur vlera e qirasë ishte më e ulët se çmimi i referencës, ne kemi bërë rivlerësimet përkatëse në tabelën e paraqitur më poshtë.

Për të llogaritur shpenzimet e qerave të fushatës zgjedhore, vlerësimet po i paraqesim në dy tabela, një për Tiranën dhe një për bashkitë e tjera. Kjo bëhet në mënyrë që vlera e qerave apo dhurimeve në natyrë të jetë sa më afër vlerës së tregut.

Nga monitorimi në terren dhe informacioni i grumbulluar për zyrat elektorale në bashkinë e Tiranës, kemi përlllogaritur në mënyrë të përafërt shpenzimet e qirasë për muajin qershor 2019. Cmimi referencë (kolona c) është cmimi sipas VKM nr. 469, datë 03.05.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qerave për qëllime tatimore”.

### Për Bashkinë Tiranë

Bashkia Tiranë	Njësia Administrative	Zona	Nr zyrave ne bashkine Tiranë	Sipërfaqja e llog me cmim reference M2	Cmimi referencë lek	Vlera 0.3%	Shpenzime qeraje me dhurim në natyrë për 1 muaj	Shpenzime qeraje me kontratë qeraje për 1 muaj
			a)	b)	c)	d)=c*0.3%	e)=b*d	
Bashkia Tirane	1	1/1	3	228	97,700	293	66,827	0
		1/2	2	40	78,000	234	9,243	0
	2	2/3	4	168	95,000	285	47,780	0
	3	3/1	1	-	77,000	231		25,000
		3/2	1	51	60,000	180	9,126	0
	4	4/1	2	-	70,000	210		28,000
		4/2	2	72	60,000	180	12,960	0
	5	5/1	2	126	190,000	570	72,048	0
		5/2	2	47	132,000	396	18,691	0
		5/3	2	125	107,000	321	39,965	0
		5/4	1	20	82,000	246	4,920	0

	6	6	5	316	65,000	195	ë,523	20,000
		7/1	2	13	120,000	360	4,500	34,500
		7/2	2	108	100,000	300	32,250	0
		7/3	3	135	85,000	255	34,425	0
	7	7/4	3	74	65,000	195	14,430	27,000
		8/1	2	36	110,000	330	11,880	20,000
		8/2	2	90	100,000	300	27,000	0
	8	8/3	3	70	72,000	216	15,120	20,000
		9/1	2	85	130,000	390	33,150	0
		9/2	2	100	100,000	300	30,000	0
	9	9/3	3	35	77,000	231	8,085	30,000
		10/1	3	50	145,000	435	21,750	125,000
		10/2	2	50	139,500	419	20,925	0
	10	10/3	0	-	102,000	306	-	0
		11/1	3	14	87,000	2ë	3,654	40,000
		11/2	2	-	75,000	225	-	30,000
	11	11/3	2	-	70,000	210	-	45,000
Bashkia Tirane	12	Baldushk	2	-	32,000	96	-	40,000
	13	Berzhite	1	-	34,000	102	-	2,500
	14	Dajt	1	50	53,500	1ë	8,025	
	15	Farke	1	50	66,500	200	9,975	
	16	Kashar	3	177	53,500	1ë	28,409	
	17	Krrabe	1	-	28,200	85	-	15,000
	18	Ndroq	1	-	34,000	102	-	30,000
	19	Petrole	4	-	53,500	1ë	-	132,000
	20	Peze	1	70	53,500	1ë	11,235	
	21	Shengjegj	0	-	23,000	69	-	
	22	Vaqar	1	-	34,000	102	-	30,000
	23	Zall-Bastar	1	30	25,000	75	2,250	
24	Zall-Herr	1	264	28,200	85	22,334		
	<b>Totali</b>		<b>81</b>	<b>2,596</b>			<b>682,579</b>	<b>694,000</b>

Nga tabela e mësipërme shpenzime në natyrë janë 682 579 lekë dhe shpenzime me kontratë qeraje 694 000 lekë. Në total shpenzimi qerasë për Bashkinë Tiranë për muajin qershor është **1 376 579 lekë**.

Në deklaratimet e PS shpenzimi i raportuar për Bashkinë Tiranë si dhurim në natyrë është 1,629,300 lekë dhe shpenzimi i qerasë është 2,230,750 lekë. Nga verifikimet e kontratave diferenca vjen nga periudha e llogaritjes. Partia Socialiste e Shqipërisë ka llogaritur këto shpenzime për një periudhe 3 muaj apo ne pak kontrata 6 muaj. **Shpenzimi total i qerasë i llogaritur dhe paguar nga PS është 3,860,050 lekë**.

### Për Bashkitë e tjera

Nr	Qarku	Bashkia	Nr zyrave	Sipërfaqja e llog me cmim reference M2	çmimi reference	Vlera 0.3%	Shpenzime qeraje (kontratë huapërdorje)	Shpenzime qeraje (kontratë qeraje)
			a)	b)	c)	d)=c*0.3%	e)=b*d	
1	Shkollë	Malësi e Madhe	0	0	40,500	122	-	

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

2		Shkodër	3	265	58,000	174	46,110	44,130
3		Vau Dejës	1	50	24,300	73	3,645	
4		Pukë	1	40	22,000	66	2,640	
5		Fushë-Arrëz	1	40	7,500	23	900	
6	Kukës	Tropojë	1	-	27,900	84	-	40,000
7		Has	1	50	24,500	74	3,675	
8		Kukës	1	-	54,000	162	-	34,020
9	Lezhë	Lezhë	8	220	56,000	168	36,960	200,000
10		Mirditë	2	30	42,000	126	3,780	
11		Kurbin	2	50	42,500	128	6,375	
12	Dibër	Mat	1	110	44,300	133		20,000
13		Klos	1	210	32,000	96	20,160	
14		Bulqizë	1	30	41,800	125	3,762	
15		Dibër	1	30	49,000	147	4,410	
16	Durrës	Krujë	2	29	51,000	153	4,437	28,000
17		Durrës	29	490	67,500	203	142,388	301,400
18		Shijak	2	60	41,000	123	7,380	
19	Tiranë	Vorë	2	74	51,500	155	11,433	
20		Kamëz	2	223	52,000	156		35,000
21		Tiranë (tabele me vete)	0	-	-	-	-	
22		Kavajë	2	120	51,000	153	18,360	
23		Rrogozhinë	1	75	41,000	123	9,225	
24	Elbasan	Peqin	2	108	39,000	117	12,636	15,000
25		Belsh	1	95	35,000	105	9,975	
26		Cërrik	1	30	38,300	115	3,447	
27		Elbasan	6	285	50,300	151	43,007	
28		Gramsh	1	-	43,000	129	-	
29		Librazhd	4	197	44,000	132	26,004	
30		Prrenjas	2	205	41,780	125		30000
31	Fier	Lushnjë	21	945	40,100	120	113,684	
32		Divjakë	5	-	40,100	120	-	100,000
33		Fier	1	-	-	-	-	
34		Patos	1	40	40,100	120	4,812	
35		Roskovec	5	335	30,000	90	30,150	
36		Mallakastër	0	-	30,000	90	-	
37	Berat	Ura vajgurore	1	103	37,000	111	11,433	
38		Kucovë	1	60	36,000	108	6,480	
39		Berat	7	825	41,400	124	102,465	51000
40		Polican	2	450	26,000	78	35,100	
41		Skrapar	0	-	25,000	75	-	
42	Korçë	Pogradec	5	120	49,900	150	17,964	60,000
43		Maliq	1	30	27,800	83	2,502	
44		Pustec	1	30	35,000	105	3,150	

45		Devoll	1	30	35,000	105	3,150	
46		Korçë	9		45,800	137		170,000
47		Kolonjë	2	100	23,000	69	6,900	
48	Gjirokastrë	Përmet	1	60	37,000	111	0	
49		Kelcyrë	1	-	24,000	72	-	30,000
50		Memaliaj	1	30	15,000	45	1,350	
51		Tepelenë	1	16	32,500	98	1,560	
52		Gjirokastrë	4	160	47,400	142	22,752	
53		Libohovë	1	-	27,000	81	-	7,000
54		Dropull	1	-	27,000	81	-	15,000
55	Vlorë	Vlorë	10	91	ë,800	185	16,871	128,900
56		Selenicë	1	100	25,000	75	7,500	
57		Himarë	1	27	58,000	174	4,698	
58		Delvinë	0	-	26,750	80	-	
59		Sarandë	2	65	56,000	168		30,000
60		Konispol	1	40	28,000	84	3,360	
Totali				<b>7,ë8</b>			<b>816,589</b>	<b>1,334,450</b>

- Shpenzime qeraje në natyrë janë 816 589 lekë dhe shpenzime me kontratë qeraje janë 1 334 450 lekë në total shpenzimi qerasë për Bashkitë e rretheve është **2 151 039 lekë**.

Sipas raporteve javore të ndërmjetme të monitorimit, pothuajse në të gjitha zyrat elektorale të monitoruara u konstatuan paisje zyre si tavolina, karrige, rafte të ndyshme, kompjutera. Këto paisje zyre ishin të ambjenteve të marra me kontratë qeraje ose kontratë huapërdoreje. Nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë nuk është llogaritur shpenzimi si: shpenzim qeraje ose shpenzim në natyrë, për përdorimin e tyre.

Sipas kontratave të qerave ose huapërdorjeve, ku thuhet se: “Qeramarrësi do të paguajë të gjitha shpenzimet për mirëmbajten e sendit, shpenzimet për energji dhe ujë gjatë periudhës së kontratës, kundrejt faturave përkatëse“, subjekti zgjedhor nuk i ka llogaritur shpenzimet për energji dhe ujë, gjatë periudhës së kontratës.

Nga ana jonë u bë një vlerësim në mënyrë statistikore për të dyja rastet.

- Për përdorimin e paisjeve të zyrave elektorale llogariten **223,000** lekë, dhurim në natyrë .
- Shpenzimi për energji dhe uje po e vlerësojmë në mënyrë statistikore **175,400** lekë.

Në deklaratimet e PS shpenzimi i raportuar për bashkinë e rretheve si dhurim në natyrë është **524,461** lekë dhe shpenzimi i qerasë është **1,673,300** lekë. Nga verifikimet e kontratave diferenca vjen për arsye se: Në disa bashki të vendit ka kontrata qeraje dhe huapërdoreje që janë llogaritur e paguar nga kandidatët për kryetar bashkie.

## KONKLUZION

**Shpenzimi i qerases për muajin qershor i llogaritur nga ana jonë për (Tiranën dhe bashkitë e tjera) për fushatën zgjedhore 2019 është 3,926,018 lekë.**

- 1,897,568 lekë dhurim në natyrë
- 2,028,450 lekë shpenzime me kontratë qeraje

**Në deklaratimet e PS shpenzimi i llogaritur dhe i paguar për të gjitha bashkitë e vendit është 6,057,811 lekë. Shpenzimi i llogaritur nga PS përfshin një periudhë më të gjatë se një muaj.**

- 2,153,761 lekë si dhurim në natyrë
- 3,904,050 lekë si shpenzime me kontratë qeraje.

### **Parregullsitë e vërejtura gjatë kostimit të zyrave zgjedhore:**

**1.** Në bashkinë **Lushnjë**, nga kontrolli i kontratave të qerave rezultoi se nuk janë të shënuara sipërfaqet e zyrave. Kjo përbën vështirësi për vlerësimin e drejtë të tyre.

**2.** Kishim raste të përlllogaritura gabim të vlerës se dhurimit në natyrë në **Elbasan e Peqin**, ku kontratat ishin vlerësuar me vlerë më të ulët se vlera e përcaktuar sipas cmimeve të referencës. Kjo bie ndesh me udhëzimin nr. 3 datë 28.12.2016, të Entit të Banesave “kostot mesatare të banesave për vitin 2016” si dhe në VKM nr. 469 datë 03.05.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qerave për qëllime tatimore”.

**3.** Në bashkinë **Durrës** në dy kontrata qeraje çmimi i vendosur në kontratë është më i ulët se çmimi i referencës. Janë bërë vlerësime të kontratave të qerasë, nga ana jonë, me qiradhënës Artur Ballën, Rruga N. Spiru, me sipërfaqe 221 m2 dhe vlerë 12 000 lekë. Llogaritjet janë bërë me çmim reference, pra duhej 44 863 leke, diferenca është prej 32 863 leke që është llogaritur si dhurim në natyrë sipas udhëzimit nr.3 datë 02.06.2017. Kontrata e qerasë në Rr “A. Gega” me sipërfaqe 100 m2 ka vlerë 10 000 lekë. Diferenca 10 300 është llogaritur si dhurim në natyrë.

**4.** Nga ana e subjektit zgjedhor PS e Shqipërisë nuk janë llogaritur shpenzime qeraje ose dhurimi në natyrë, përdorimi i paisjeve të zyrave zgjedhore si dhe shpenzime për energji dhe ujë.

### **b. Aktivitetet, eventet dhe materialet e fushatës**

Me marrjen e misionit të monitorimit, kërkuam listën e aktiviteteve të subjektit zgjedhor. Nuk kishte një listë aktiviteteve të planifikuara. Ne merrnim informacion nga përfaqësuesja e PS Dhurata Isufaj çdo ditë për aktivitetet e radhës. Kemi monitoruar aktivitetet të mëdha me zgjedhje ku prezantoheshin kandidatët për Kryetar bashkie nga kryeministri z. Edi Rama. Gjithashtu kemi monitoruar edhe takime të vogla elektorale në njësitë administrative të Tiranës dhe në bashkitë

Krujë, Tepelenë dhe Vlorë. Në raportet javore të ndërmjetme të monitorimit janë dhënë informacionet dhe detajet e këtyre aktiviteteve.

Nga informacioni i grumbullar kemi përlogaritur kostot e aktiviteteve të monitoruara. Llogaritjet tona mbështeten në llojet e shërbimeve të identifikuar për cdo aktivitet, si dhe çmimin e shërbimit të furnitorëve sipas llojit të shërbimit apo furnizimit. Më pas, ne kërkuam nga subjekti zgjedhor faturat e lëshuara për të bërë krahasimin e kostove. Faturat e shpenzimeve të lëshuara nga subjekti zgjedhor për këto aktivitete, janë faturuar pjesërisht nga PS dhe pjesërisht nga Kandidatët për kryetar të bashkive.

Po listojme tabelat e llogaritjeve për eventet e monitoruara. Në tabelat e mëposhtme nuk ka një ndarje faturash të lëshuara në emër të PS apo kandidatit për kryetar bashkie. Tabela është krahasuese për koston e aktivitetit.

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Cërrik datë 06/06/2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	cope	1300	200	260,000	289,200	
2	Bluza me logo të PS	cope	20	1,200	24,000	298,200	
3	Karrige me qera	cope	1500	150	225,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		135,000	135,000		
5	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		100,000	100,000		
	<b>Totali</b>				<b>744,000</b>	<b>587,400</b>	<b>156,600</b>

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Belsh date 06/06/2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	1500	200	300,000	335,880	
2	Karrige me qera	copë	1800	150	270,000	700,000	
3	Bluza me logo të PS	copë	25	1,200	30,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000		
5	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		135,000	135,000		
	<b>Totali</b>				<b>1,085,000</b>	<b>1,035,880</b>	<b>49,120</b>

Llogaritja e Shpenzimeve te aktivitetit Ura Vajgurore date 07/06/2019							
---	--	--	--	--	--	--	--



Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e perdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	1300	200	260,000	270,300	
2	Karrige me qera	copë	1700	150	255,000	108,800	
3	Bluza me logo të PS	copë	40	1,200	48,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		135,000	135,000	195,600	
5	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		100,000	100,000		
	<b>Totali</b>				798,000	573,900	224,100

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Kuçovë datë 07/06/2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	1400	200	280,000	216,600	
2	Karrige me qera	copë	1800	150	270,000	95,000	
3	Bluza me logo të PS	copë	30	1,200	36,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		135,000	135,000	90,000	
5	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		100,000	100,000	287,500	
	<b>Totali</b>				821,000	689,100	381,900

Llogaritja e Shpenzimeve te aktivitetit Berat date 08/06/2019							
Sipas Monitorimit ne terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	2000	200	400,000	307,200	
2	Karrige me qera	copë	2600	150	390,000		
3	Bluza me logo të PS	copë	25	1,200	30,000		
4	Sherbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000	526,500	
5	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		135,000	135,000		
	<b>Totali</b>				1,305,000	833,700	471,300

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Lushnjë datë 12.06.2019							
---	--	--	--	--	--	--	--

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	1500	200	300,000	433,200	
2	Karrige me qera	copë	2000	150	300,000		
3	Bluza me logo të PS	copë	50	1,200	60,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000	849,100	
5	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		135,000	135,000		
6	Pije tëndryshme	Lekë		100,000	100,000		
	<b>Totali</b>				1,245,000	1,282,300	(37,300)

Llogaritja e Shpenzimeve të takimit elektorral sheshi 3 Racat, Vlorë (Dritan Leli) datë 12.06.2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	250	200	50,000	40,000	
2	Karrige me qera	copë	380	150	57,000	30,000	
3	Bluza me logo të PS	copë	20	1,200	24,000		
4	Shërbim, skene, video, ekran Led	lekë		200,000	200,000	190,000	
5	Shërbim fonia+ ndricim	lekë		150,000	150,000	180,000	
	<b>Totali</b>				481,000	440,000	41,000

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Librazhd datë 13.06.2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	2600	200	520,000	433,200	
2	Karrige me qera	cope	2800	150	420,000	450,000	
3	Bluza me logo të PS	cope	200	300	60,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	leke		350,000	350,000		
5	Shërbim skene, fonia, ndricim	leke		135,000	135,000		
6	Transporti	Leke		100,000	100,000		
	<b>Totali</b>				1,585,000		883,200

*Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë*

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Prrenjas datë 13.06.2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	600	200	120,000	270,600	
2	Karrige me qera	copë	600	150	90,000	700,000	
3	Bluza me logo të PS	copë	40	1,200	48,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000		
5	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		135,000	135,000		
6	Transporti	Lekë		150,000	150,000		
	<b>Totali</b>				893,000	970,600	(77,600)

Llogaritja e Shpenzimeve të takimit elektoral Tiranë (Erion Veliaj) datë 13/06/2019							
Sipas Monitorimit në terren shkolla Naim Frasheri						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Karrige me qera	copë	200	150	30,000	24,000	
2	Bluza me logo të PS	copë	20	1,200	24,000	114,000	
3	Shërbim, audio, video, Ledwall	lekë		100,000	100,000		
4	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		50,000	50,000		
	<b>Totali</b>				204,000	138,000	66,000

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Korçe datë 15.06.2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Nësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	2200	200	440,000	245,880	
2	Karrige me qera	copë	2000	150	300,000	600,000	
3	Bluza me logo të PS	copë	210	1,200	252,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000		
5	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		135,000	135,000		
6	Pije dhe ushqime	Lekë					100,000
	<b>Totali</b>				1,477,000	945,880	531,120

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Pustec datë 15.06.2019							
--	--	--	--	--	--	--	--

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	29	200	5,800	54,000	
2	Karrige me qera	copë	180	150	27,000		
3	Flamunj Maqedons	copë	2	200	400		
4	Bluza me logo të PS	copë	10	1,200	12,000		
5	Shërbim, audio, video, Ledwall	lekë		100,000	100,000		
6	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		50,000	50,000	70,000	
7	Transporti I pjesmarresve	Lekë		10,000	10,000		
8	Pije të ndryshme	Lekë		5,000	5,000	25,000	
	<b>Totali</b>				210,200	149,000	ë,200

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetit Pogradec datë 16.06.2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	800	200	160,000	307,200	
2	Karrige me qera	copë	1000	150	150,000		
3	Bluza me logo të PS	copë	20	1,200	24,000	17,000	
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000	200,000	
5	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		135,000	135,000		
6	Transporti I pjesmarresve	Lekë		85,000	85,000		
	<b>Totali</b>				904,000	524,200	379,800

Llogaritja e Shpenzimeve të takimit elektoral Tiranë (Erion Veliq) datë 18.06.2019, njësia 10							
Sipas Monitorimit në terren te gjimnazi Qemal Stafa						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Karrige me qera	copë	100	150	15,000	24,000	
2	Bluza me logo	copë	20	1,200	24,000		
3	Shërbim, audio, video, Ledëall	lekë		100,000	100,000	114,000	
4	Shërbim skene, fonia,ndricim	lekë		50,000	50,000		

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

Totali				189,000	138,000	51,000
--------	--	--	--	---------	---------	--------

Llogaritja e Shpenzimeve të takimit elektoral Tepelenë (Tërmet Peci )datë 18.06.2019							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Karrige me qera	copq	100	100	10,000	Nuk ka fatura	
2	Bluza me logo	copq	15	1,200	18,000		
3	Shqrbim skene, fonia,ndricim	copq	1	8,000	8,000		
	Totali				36,000		36,000

Llogaritja e Shpenzimeve të Aktivitetit Vau i Dejes date 21.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	600	200	120,000	108,300	
3	Bluza me logo	copë	45	1,200	54,000	180,000	
2	Karrige me qera	copë	500	150	75,000		
4	Shërbim Fonie	lekë		60,000	60,000		
5	Skena, audio	lekë		48,000	48,000		
6	Transporti materialeve	Lekë		15,000	15,000		
	Totali				372,000	288,300	83,700

Llogaritja e Shpenzimeve të Aktivitetit Shkodër datë 21.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	1800	200	360,000	108,300	
2	Karrige me qera	copë	2000	100	200,000	312,000	
3	Bluza me logo	copë	35	1,200	42,000		
4	Shërbim Fonie	lekë		150,000	150,000		
5	Skena, audio	lekë		50,000	50,000		
	Totali				802,000	420,300	381,700

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

Llogaritja e Shpenzimeve të Aktivitetit Durrës datë 24.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	2100	200	420,000	774,900	
2	Karrige me qera	copë	2000	150	300,000	1,000,000	
3	Bluza me logo	copë	250	1,200	300,000		
4	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		450,000	450,000		
5	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		135,000	135,000		
6	Transporti				200,000		
	<b>Totali</b>				1,805,000	1,774,900	30,100

Llogaritja e Shpenzimeve të Aktivitetit Kukës date 25.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	2200	200	770,000	548,300	
2	Karrige me qera	copë	2000	150	300,000		
3	Bluza me logo	copë	250	1,200	300,000	90,000	
4	Kapele me logo të PS	copë	150	350	52,500	25,200	
5	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000	988,800	
6	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		135,000	135,000		
7	Transporti pjesmarresve	Lekë		65,000	65,000		
	<b>Totali</b>				1,972,500	1,652,300	320,200

Llogaritja e Shpenzimeve të Aktivitetit Tropojë datë 25.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	1100	200	220,000	198,300	
2	Karrige me qera	copë	1000	150	150,000		
3	Bluza me logo	copë	40	1,200	48,000		
4	Kapele me logo të PS	copë	35	500	17,500		

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

5	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		350,000	350,000	800,000	
6	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		135,000	135,000		
7	Transport I pjesmarresve	Lekë		65,000	65,000		
Totali					985,500	998,300	(12,800)

Llogaritja e Shpenzimeve të Aktivitetit Elbasan datë 26.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Karrige me qera	copë	2500	150	375,000		
2	Flamuj kombëtare	copë	2800	200	560,000	829,800	
3	Bluza me logo	copë	200	1,200	240,000		
4	Kapele me logo të PS	copë	150	500	75,000		
5	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		450,000	450,000	1,300,000	
6	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		135,000	135,000		
7	Transporti pjesmarresve	Lekë		150,000	150,000		
8	Fotografi, montime	Lekë		35,000	35,000		
9	Pije dhe ujë	Lekë		45,000	45,000		
Totali					2,065,000	2,129,800	(64,800)

Llogaritja e Shpenzimeve të takimit elektoral Tiranë (Erion Veliaj) datë 27.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren në qender te bashkia (sheshi Skenderbej)						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Karrige me qera	copë	900	150	135,000	120,000	
2	Bluza me logo EV (erion veliaj)	copë	250	1,200	300,000		
3	Shërbim, audio, video, Ledwall	lekë		100,000	100,000	420,000	
4	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		50,000	50,000		
Totali					585,000	540,000	45,000

Llogaritja e Shpenzimeve të aktivitetin Vorë datë 27.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		

*Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë*

1	Flamuj kombëtare	copë	700	210	147,000		
2	Karrige me qera	copë	650	150	97,500		
3	Bluza me logo	copë	75	1,200	90,000	174,960	
4	Shërbim, audio, video, Ledwall	lekë		150,000	150,000		
5	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		100,000	100,000	331,345	
	<b>Totali</b>				584,500	506,305	78,195

Llogaritja e Shpenzimeve të Aktivitetit Vlorë datë 28.06.2019,							
Sipas Monitorimit në terren						Sipas Faturave te subjektit zgjedhor ( vlerë)	Diferenca
Nr	Materialet e përdorura	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera		
1	Flamuj kombëtare	copë	9500	200	1,900,000	823,749	
2	Bluza me logo	copë	150	1,200	180,000	150,000	
3	Kapele me logo të PS	copë	150	250	37,500	30,000	
4	Karrige me qera	copë	9500	70	665,000	2,026,000	
5	Shërbim, audio, video, ekran Led	lekë		450,000	450,000		
6	Shërbim skene, fonia, ndricim	lekë		135,000	135,000		
7	Printime color	Lekë		100,000	100,000	199,551	
8	Fishekzjarre	Lekë		100,000	100,000	120,000	
9	Shërbim filmimi dhe montazhi	Lekë		30,000	30,000	149,700	
10	Ushqim dhe pije (ujë)	Leke		50,000	50,000		
	<b>Totali</b>				3,647,500	3,499,000	148,500

Në këto evente, materialet promociionale të përdorura ishin pothuajse të njëjta, si flamuj kombëtarë, bluza me logo të PS dhe bashkive, kapele me logo të PS si dhe banera me logo te bashkive. Materialet promociionale ( kryesisht flamuj ) janë blerë me fatura tatimore nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe shperndaheshin sipas aktiviteteve të organizuara.

Kostot e aktiviteteve të llogaritura nga ana jonë janë krahasuar me dokumentacionin dhe faturat e paraqitura nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Nga llogaritjet sipas monitorimit kostoja për eventet e monitoruara është 24 796 200 lekë

Nga faturat e marra nga subjekti zgjedhor kostoja e monitoruara është 21 000 365 lekë

**Diferenca për aktivitetet e monitoruara është 3 795 835 lekë.**



Nga subjekti zgjedhor PS e Shqipërisë, janë kryer shpenzime të fushatës zgjedhore në shumën 44 556 803 lekë. Shpenzimet për aktivitetet me fatura tatimore zënë peshën më të madhe në totalin e shpenzimeve ose rreth 28.5 %. Materialet promocionale të përdorura në fushatën zgjedhore janë kryesisht flamuj kombëtare, bluza me logo të PS, kapele me logo, banera. Një kontribut është shpenzuar edhe për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga termeti (15.71%) të totalit të shpenzimeve.

**Tabela e shpenzimeve të fushatës për Partinë Socialiste të Shqipërisë.**

Nr rend	Emertimi	Vlera leke	Shpenz.ne %
1	Aktivitetet	12,716,800	28.54
2	Materiale promocionale,(bluza,kapele,baner)	2,404,000	5.40
3	Shpenzime per flamunj	10,507,450	23.58
4	Kontribut per Termetin Floq (Korce)	7,000,000	15.71
5	Qera zyra elektorale	3,904,050	8.76
6	Ambjente me qera	922,968	2.07
7	Kafe,pije, ushqim	1,431,255	3.21
8	Kancelari + softëere	1,316,940	2.96
9	karburant, transport	1,514,835	3.40
10	Karrige me qera	720,000	1.62
11	Media sociale	1,053,039	2.36
12	Tatim ne burim	585,608	1.31
13	Te ndryshme	479,248	1.08
	<b>Totali</b>	<b>44,556,803</b>	<b>100</b>

Nga kandidatët për kryetar bashkie, janë kryer shpenzime të fushatës zgjedhore në shumën 32 387 070 lekë. Shpenzimet për aktivitetet me fatura tatimore në totalin e shpenzimeve zënë 10,547,805 lekë ose rreth 33.09 %. Materialet promocionale janë 4,639,929 leke ose 14.56 %. Në shpenzimet administrative qe zënë 47.76 % të totalit, janë llogaritur si shpenzimet e karburantit, qera zyre, kancelari etj.

**Tabela e shpenzimeve të fushatës të kandidatëve për kryetar bashkie.**

Nr rend	Emertimi	Vlera leke	Shpenz.ne %
1	Aktivitetet	10,547,805	33.09
2	Materiale promocionale,(bluza,kapele,baner)	4,639,929	14.56
3	karburant, transport	250,800	0.79
4	Shpenzime administrative	15,724,142	47.76

5	Media sociale	897,326	2.81
6	Botime	135,000	0.42
7	Konsulenca	192,068	0.60
	<b>Totali</b>	<b>32,387,070</b>	<b>100</b>

**Parregullësitë e konstatuara në aktivitetet e monitoruara janë :**

- 1 Aktivitetet e organizuara në bashkitë: Ura vajgurore, Korçë, Shkodër, Berat, sipas monitormit kanë rezultuar me diferenca në numrin e flamujve, nr e karrigeve, si dhe bluza me logo. Shërbimet e këtyre aktiviteteve janë organizuar nga furnitorë të ndryshëm, të cilët më kanë sjellë vështirësi në vlerësimin e cilësisë së shërbimit.
- 2 Aktiviteti i organizuar në bashkinë Librazhd ka diferencë në koston e aktivitetit. Duke mos patur një faturë analitike të furnitorit (me situacion bashkëngjitur), kishim vështirësi në analizimin e shpenzimeve sipas zërave dhe përputhshmërisë së shërbimeve.
- 3 Aktivitetet e organizuara (takime elektorale) të kandidatëve për kryetar bashkie Tepelenë, Kolonjë dhe Krujë, nuk kishin fatura për të dokumentuar shpenzimet e eventit dhe për të bërë krahasimin e koston se aktivitetit.
- 4 Në Bashkinë Kamëz, gjatë ballafaqimit me dokumentat e raportuara nga subjekti zgjedhor, nuk gjetëm të pasqyruara në shpenzimet e PS apo kandidatit, qeranë e dy zyra të monitoruara në raportin e javës së parë të monitorimit, ( një zyrë në Bulevardin Blu Pall Ana Konstruksion, dhe tjetra në Paskuqan).
- 5 Nga verifikimi i dokumentave nuk janë zbatuar procedurat e Udhëzimit nr. 3 datë 02.06.2017. Sipas pikës 1 të nenit 2, ku thuhet: “Përlllogaritja e koston së veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partite politike gjatë fushatës zgjedhore bëhet në bazë të **çmimit të prokurorimit** të këtyre mallrave ose shërbimeve”. Shpenzimet e fushatës zgjedhore të bëra nga vetë partia janë 44 556 77 lekë. Financimi nga fondet publike për fushatën zgjedhore për PS është 40 868 138 lekë. Fondet publike mbulojnë rreth 92 % të këtyre shpenzimeve.
- 6 Datat e faturave tatimore nuk përkojnë me datat e zhvillimit të eventeve, në disa raste ato janë të lëshuara më vonë se data e mbajtjes së eventit, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 51 “Lëshimi i faturës tatimore”.
- 7 Faturat tatimore janë të lëshuara në menyrë globale, pa situacion analitik bashkëngjitur, jo në përputhje me ligjin nr.92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, neni 101 pika e.”
- 8 Ka raste kur faturat janë lëshuar në emër të PS dhe pagesat janë bërë nga kandidatët si në bashkitë Dibër, Lushnjë etj.

**c. Vlerësimi i respektimit të kerkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor**

- Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe punës monitoruese në terren, **nuk u identifikuan raste të shkeljeve ligjore te Udhëzimit nr. 1 datë 31.05.2017, të KQZ-së,**

**pikërisht neni 2, pika 1**, për perdorimin dhe afishimin e materialeve propogandistike zgjedhore, përfshirë flamuj dhe postera të ndaluara (të palejuara), në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.

- Në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë 31.05.2017 , pikërisht neni 2, pika 2. “Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat ”**kemi evidentuar parregullsi të permendura në seksionin a/1 zyrat zgjedhore.**
- Nga 40 bashki që i janë përgjigjur shkresës sonë për numrin dhe adresat e zyrave elektorale, 5 nga këto kanë konfirmuar që Partia Socialiste nuk ka njoftuar për hapjen e zyrave zgjedhore. Pra, për këto bashki Partia Socialiste **nuk ka zbatuar Udhëzimin nr.1 date 31/05/2017 pika 3 e nenit 2** ku thuhet që subjekti zgjedhor brenda 5 ditëve njofton Kryetarin e Bashkisë për adresat e zyrave zgjedhore.
- Lidhur me kostimin e veprimtarive, shërbimeve apo materialeve për qëllime zgjedhore, **nuk janë zbatuar rregullat e përshkruara në udhëzimin nr.3 datë 02/06/2017 neni 2 pika 1** “Për përllogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore”. Sipas pikës 1 të nenit 2, përllogaritja e kostos së veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore bëhet në bazë të **çmimit të prokurorimit të këtyre mallrave ose shërbimeve.**
- Datat e faturave tatimore nuk përkojnë me datat e zhvillimit të eventeve, në disa raste ato janë të lëshuara më vonë se data e mbajtjes së eventit, **jo në përputhje me ligjin, 9920**, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 51 “Lëshimi i faturës tatimore, ku thuhet se, shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Nuk është **zbatuar edhe ligji nr. 92/2014** për “Tatimin mbi vlerën e shtuar nr RSH” neni 99, pika 1 dhe 4. “Fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallit ose shërbimit, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe”, “Personi i tatuashëm, që kryen një furnizim shërbimesh, detyrohet të lëshojë një faturë për atë furnizim në momentin kur shërbimet janë kryer”.
- Faturat tatimore ishin të lëshuara në menyrë globale pa situacion analitik bashkëngjitur, **jo në përputhje me ligjin 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, neni 101 pika e**, Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar nga Ministri i Financave dhe përmban informacionin e mëposhtëm: “sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera”
- Për shpenzimet e transportit nuk kemi një transparencë në llojin e shërbimit. Pjesmarrësit janë sjellë në aktivitetet me autobus, furgon privat ose me makinat e PS apo FRESH-it. Duhet të kishim një ndarje të llojit të shërbimit sipas përkatësisë. **Kjo nuk është në përputhje me legjislacionin tatimore në fuqi.**

- Në lidhje me dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor, konkluduar se shpenzimet janë dokumentuar me fatura tatimore në përputhje **me ligjin nr 9920 datë 15.05.2008 neni 49 pika 1**. Faturat tatimore janë likuaduar nëpërmjet llogarisë bankare te PS, në Credins Bank.
- Në lidhje me respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, nuk u identifikuan shkelje te Kodit Zgjedhor, neni 90 pika 3, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike **nuk identifikuam mosrespektim të kufirit maksimal të shpenzimeve**. Shpenzimet totale nuk e kalojnë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87/3 të këtij kodi.
- Partia Socialiste e Shqipërisë ka zbatuar kërkesat ligjore për hapjen e llogarisë së posacme në një bankë, për dhurimin e fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë **sipas Kodit zgjedhor, neni 90, pika 2**.
- Në lidhje me transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj para dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike, konstatoam se nuk kishte shkelje ligjore. Nga monitorimi dhe inspektimi i dokumentacionit financiar dhe transaksioneve financiare . **nuk identifikuam transaksione të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore**.
- Mbulimi i fushatës zgjedhore nga media audiovizive rregullohet në mënyrë të detajuar nga Kodi Zgjedhor. Sipas Ligjit, çdo parti që ka fituar mbi 20 % të vendeve në zgjedhjet e fundit parlamentare duhet të marre dy herë më shumë mbulim në edicionet informative se partitë e tjera parlamentare. Në lidhje me shpenzimet e fushatës zgjedhore në transmetimet televizive dhe në media Partia Socialiste e Shqipërisë **ka zbatuar kërkesat ligjore të Kodit Zgjedhor , neni 80 pika a dhe b**.
- **Mediat Online** , facebook, instagram pothuajse janë të pa rregulluar me ligj, dhe si të tilla nuk mundet te kontrollohen, dhe të shprehemi për to.
- Në shpenzimet e fushatës zgjedhore bazuar në vendimin nr. 5, datë 10.06.2019, të Kryesise së Partisë Socialiste të Shqipërisë, është vendosur që nga fondi i fushatës së 30.06.2019, vlera prej 7 000 000 lekë të përdoret si kontribut për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti në fshatin Floq të rrethit Korçë. Data e transaksionit është më 24.06.2019 në Credins Bank (llogari fushate). Kontributi nga fondet e fushatës zgjedhore, për zonat e dëmtuara nga tërmeti, nuk është **në përputhje me dispozitat ligjore, pasi nuk i shërben fushatës zgjedhore**. Destinacioni i shpenzimeve duhet ti referohet fushatës zgjedhore.
- Nuk i janë përgjigjur kërkesave dhe informacioneve tona si me email ashtu edhe me telefon kryetarët e Partisë Socialiste dhe Kandidatët për kryetar bashkie në bashkitë Lushnjë, Durrës dhe Gjirokastrë, për verifikime të informacioneve të kërkuara në lidhje me zyrat elektorale

dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore. **Kjo bie ndesh me nenin 91, pika 2, te Kodit Zgjedhor,** “Subjektet zgjedhore duhet të venë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja, çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas këtij Kodi”.

- Në lidhje me Rregullat e brendshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve, konkluzioni nga monitorimi i dokumentacionit financiar dhe i raporteve të shpenzimeve të përgatitura nga subjekti zgjedhor është se: subjekti zgjedhor (Partia Socialiste e Shqipërisë) mban dhe zbaton rregulla te brendshme në lidhje me dokumentacionin financiar. Subjekti ka staf të punësuar në pozicionin e financierit që zbaton rregullat kontabël dhe legjislacionin fiskal dhe ka marre pjesë në trajnimin e organizuar nga KQZ në muajin Maj 2019, për t’u aftësuar në përdorimin e formateve të reja të raportimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore 2019 të miratuara nga KQZ.

### **iii. Komunikimet e ekspertit financiar me subjektin zgjedhor dhe palët e treta.**

Më datë 01.06.2019 kontaktuam në telefon me përfaqesuesen e financës znj. Dhurata Isufaj për ta informuar në lidhje me shërbimin që do të kryenim në zbatim të kontratës me KQZ-në dhe njëkohesisht për të marrë informacionin e nevojshëm për aktivitetet e subjektit zgjedhor, zyrat elektorale. Në dispozicion na u vunë listat e kontakteve, nr. telefoni dhe adresa e-maili të kryetarëve të Partive Socialiste sipas bashkive dhe kandidatëve për kryetar Bashkie për bashkitë e vendit. Komunikimi i parë ishte me anë të email-it ku ne si grup pune, pas prezantimit si eksperte financiare ju kërkua listen e aktiviteteve, takimeve elektorale apo çdo aktivitet tjetër që do të organizonin gjatë fushates zgjedhore të 30 Qershorit. Komunikimi ka vazhduar gjatë gjithë fushatës zgjedhore. Grupi i punës filloi monitorimin në terren në disa Bashki të vendit për të verifikuar dhe identifikuar vendndodhjen apo adresat e sakta të zyrave elektorale të subjektit zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Gjate javës së parë të monitorimit në shumicën e bashkive morëm informacionin për zyrat elektorale ku na u tha se zyrat akoma nuk ishin hapur e po bëheshin listat dhe përcaktoheshin adresat se ku do të hapeshin keto zyra. Më pas monitoruam në terren dhe pamë se zyrat elektorale nuk ishin bërë funksionale. Ishin bërë vetëm planifikimet dhe numri që do te hapeshin. Vetëm pas javës së parë zyrat elektorale filluan të bëhen funksionale

Në ditët në vijim iu drejtua me kërkesë zyrtare (kërkesë e dërguar me postë rekomande) Kryetarëve të 60 bashkive në vend, për të na informuar ne lidhje me adresat e sakta të zyrave elektorale për Subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të KQZ Nr. 1 datë 31.05.2017.

Në vijim teksti i kërkesës drejtuar kryetareve të 60 bashkive:

*Ne kërkojmë nga ju, të na vini në dispozicion adresat e sakta të zyrave elektorale për subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", bazuar ne UDHËZIMIN Nr. 1 date 31.05.2017 te KQZ "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", Neni 2, Pika 3, ku thuhet se :*

*"Subjekti zgjedhor është i detyruar që brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi (Udhëzimi Nr.1 date 31.05.2017) të njoftojë me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse, adresat e sakta të zyrave elektorale. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit administrata e bashkisë, bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propogandistike".*

Gjatë gjithë periudhës së monitorimit të fushatës zgjedhore komunikimi me përfaqesuesit e subjektit zgjedhor ka qënë korrekt për të marrë informacionin e duhur në lidhje me kryerjen e shërbimit, sipas kontratës së nënshkruar datë 01.06.2019. Informacionet janë marrë me email nga financierja e PS te Shqipërisë znj. Dhurata Isufaj si dhe nga kryetarët e Partise Socialiste në bashkitë e rretheve. Ne kemi komunikuar edhe me kandidatët për kryetare bashkie, të cilët na kanë deleguar personat përgjegjës për dhënien e informacionit. Jemi informuar çdo ditë nga qendra e PS për eventet që do të mbaheshin. Për arsye të numrit të madh të takimeve elektorale komunikimi me email ka qënë më i përdorur dhe më me efektivitet për të grumbulluar gjithë informacionin e kërkuar nga ana jonë. Por në disa raste kemi hasur vështirësi për dërgimin në kohën e duhur sidomos nga rrethet në lidhje me informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Komunikimi ka qënë edhe me kandidatët për kryetar bashkie apo përfaqësuesit e tyre (financierët). Gjatë gjithë monitorimit ne kishim kontaktet tona për zhvillimin e aktiviteteve dhe takimeve elektorale apo takimeve derë me derë. Por kemi patur edhe mungesë informacioni nga disa kandidatë për kryetar bashkie apo personat përgjegjës për fushatën zgjedhore 2019, pasi nuk i janë përgjigjur kërkesave tona për grumbullimin e informacioneve.

Pas grumbullimit të informacioneve në lidhje me hapjen e zyrave zgjedhore, ne ju drejtuam me një kërkesë zyrtare me postë, disa bashkive që kanë numrin më të madh të zyrave elektorale, për të na qartësuar në lidhje me numrin e lagjeve sipas qytetëve. Pjesërisht janë kthyer përgjigje për kërkesën tonë.

Komunikimet tona kanë vazhduar në ballafaqimin me dokumentat pranë zyrës së finances te Partisë Socialiste të Shqipërisë. Dokumentacioni është i grumbulluar në zyrën e financës edhe për kandidatët e bashkive të rretheve.

#### **iv.Paraqitja e raportit të monitorimit të fushates zgjedhore të vitit 2019**

Në mbështetje të raporteve javore të ndërmjetme të monitorimit si dhe ballafaqimit me dokumentat dhe informacionin e grumbulluar, më poshtë po paraqesim një përmbledhje të përgjithshme të procesit të monitorimit gjatë fushatës zgjedhore të 30.06.2019.

Me marrjen e informacionëve paraprake, si për zyrat zgjedhore, ashtu edhe për aktivitetet e subjektit zgjedhor (PS), vazhduam punën me procesin e monitorimit gjatë gjithë muajit qershor 2019. Gjatë javës së parë u monitoruan **7 bashki** të vëndit përkatësisht, Elbasan, Belsh, Cërrik, Ura Vajgurore, Kucovë, Kamëz dhe Berat. Verifikuam zyrat zgjedhore, adresat dhe zbatimin e Udhëzimit nr. 1 datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propogandistike dhe vendet për afishimin e gjatë fushatës zgjedhore". Nuk kishte materiale propogandistike të fushatës zgjedhore të ndaluara (të palejuara) në kundërshtim me nenin 2, pika 1 të këtij udhëzimi.

Monitoruam gjithashtu edhe **5 aktivitete** në këto Bashki si Berat, Cërrik, Belsh, Ura Vajgurore dhe Kuçovë, në prezantimin e kandidatëve nga kryetari i PS z. Edi Rama. Materialet propagandistike që përdorshin ishin flamuj kombëtarë dhe bluza të veshura nga pjesmarresit në fushatë me logon e PS dhe logon e bashkive.

Në javën e dytë u monitoruan zyrat zgjedhore në **16 bashki**. U kërkuan kontratat e qerave dhe të huapërdorjes sipas rastit dhe u plotësuan formularët sipas modelit të kërkuar. Në këtë javë janë monitoruar edhe **9 aktivitete** të subjektit zgjedhor. Gjatë punës kemi vërejtur se në asnjë rast nuk ka materiale propogandistike të fushates zgjedhore të ndaluara (të palejuara), vendosja e tyre në më shumë se 5 metra nga zyra zgjedhore. Disa zyra elektorale nuk identifikohen lehtë pasi nuk ka banera apo logo që ti bëjnë të dallueshme. Ka të tjera zyra, me banera me logon “Bashkia qe Duam”, Zyra e Bashkeqeverisjes me njerezit”, “Për Shqipërinë që Duam”apo postera me logon e Partisë Socialiste. Ka disa zyra si në Vlorë, Berat, Librazhd, Pogradec dhe Korçë që nuk mundet ti identifikosh vetëm me adresat që na ka sjellë bashkia ose me informacionet e marra se ku ndodhen këto zyra. Nga verifikimet e bëra, këto zyra shërbejnë më tepër si zyra për takime elektorale gjatë mbasditeve. Gjithashtu kishte edhe lokale të individëve që janë vënë në dispozicion të Partisë Socialiste për t’i përdorur si zyrë elektorale. Në përfundim të javës së dytë të monitorimit në zyrat elektorale të monitoruara nuk kemi materiale propogandistike të fushatës zgjedhore të ndaluara (të palejuara), në më shumë se 5 m lag zyrës zgjedhore.

Në Bashkinë Librazhd në raportin e ndërmjetëm, të javës së dytë të monitorimit, është plotësuar gabim formulari i monitorimit të zyrës elektorele në adresë Bulevardi “Gjergj Golemi” në qendër të qytetit, më datë 15.06.2019, pasi kemi vendosur (PO), pra që ka kontrate qeraje. U konstatua ky gabim dhe saktësojmë se : **nuk ka kontratë qeraje për këtë zyrë zgjedhore, por zyra e përdorur si zyre elektorale është në përdorim të Partisë Socialiste sipas një Vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 1086 datë 28.10.2009 për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Librazhd , të Qarkut Elbasan.**

Në javën e tretë u monitoruan zyra zgjedhore në **22 bashki** të vëndit dhe **5 aktivitete**, kryesisht prezantimet e kandidatëve për kryetar bashkie. Në vazhdim të monitorimit të fushatës zgjedhore për javën e tretë të monitorimit (periudha 17/06/2019 – 23/06/2019), stafi ka ndjekur aktivitetet e fushates zgjedhore në disa bashki të vendit si dhe monitorimin e zyrave elektorale në terren. Ballafaqimi i tyre u bë me pergjigjjet e letrave të ardhura nga bashkitë e ndryshme. Në disa bashki, Partia Socialiste e Shqiperisë, si në: Klos, Lushnjë, Fier, Patos, Roskovec, Tepelenë, Gjirokastër, Dropull, Berat, Përmët, Shijak, Vorë, Shkodër, nuk dispononte informacionin e dërguar nga bashkitë përkatëse për adresat e zyrave zgjedhore, sipas Udhezimit nr. 1 datë 31.05.2017.

Në javën e fundit të fushates zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019, u monitoruan zyra zgjedhore në **5 bashki dhe 8 aktivitete**. U përqëndruam konkretisht në ndjekjen e aktiviteteve më të mëdha të fushatës në bashkitë kryesore të vendit. U monitoruan aktivitetet e mbylljes së fushtës zgjedhore si për bashkinë Tiranë dhe Vlorë. Gjithashtu vijuan edhe me monitorimin në Bashkitë Tiranë dhe Durrës për zyrat zgjedhore. Në përfundim të javës së katërt të monitorimit

theksojmë se në të gjitha zyrat elektorale të monitoruara nuk kemi materiale propogandistike të fushatës zgjedhore të ndaluara (të palejuara), në më shumë se 5 m larg zyrave zgjedhore. Në këtë javë identifikua se kishte raste të hapjes më shumë se një zyrë elektorale në lagje, si në qytetin e Durrësit dhe Lushnjës. Në këto bashki, siç është raportuar edhe në raportet javore, ishin planifikuar të hapeshin rreth 50 zyra elektorale, por sipas informacionit të grumbulluar dhe dokumentacionit të verifikuar u hapën rreth gjysma e tyre 29 zyra elektorale nga të cilat 10 me kontrat qeraje dhe 19 me kontrat huapërdoreje.

Në eventin e mbylljes së fushatës elektorale në **Tiranë** më datë 27.06.2019, sipas monitorimit kanë marrë pjese rreth 400 pjesmarrës. Ky event u organizua nga Partia socialiste, stafi i kandidatit të bashkise Tiranë dhe vullnetarë, dhe u mbajt në sheshin para bashkisë në qendër të kryeqytetit (Iulishte). Materialet promocionale që u përdorën ishin banera me shkrime “Bashkia që duam” dhe bluza me logo nr. 2 me shkrim EV rreth 250 copë. Kostoja e këtij mitingu kushtoi 420 000 lekë, ku përfshihej shërbimi foni, skene, stage, ledwall, ndriçimi.

Në aktivitetin e mbylljes së fushatës elektorale në **Vlorë** më datë 28.06.2019, kostoja e këtij mitingu e vlerësuar nga ana jonë është rreth 3, 647,500 lekë. Krahasuar me dokumentacionin e paraqitur nga Partia Socialiste, kostoja shkon në 3 499 000 lekë. Diferenca vjen nga vlerësimi i çmimeve të karrigeve ku sipas vlerësimit tonë çmimi i marrjes me qera të një karrike është rreth 150 lekë, ndërsa në faturën e lëshuar nga furnitori më datë 28.06.2019 është 72 lekë, si dhe nga numri i flamujve. Duke qënë se ishte event i madh i fushatës zgjedhore theksojmë se numri i pjesmarrësve ishte planifikuar rreth 12 000 vetë, por sipas monitorimit tonë nuk ishin më shumë se 10 000 veta. Numri i madh i pjesmarrësve e bënte të vështirë identifikimin e saktë të elementëve të eventit. Pjesmarrja e madhe në këtë miting, bëri që të kishim edhe shpenzime transporti me autobuza, furgona dhe makina të vogla. Vlerësimi i kostos së transportit është shumë i vështirë për arsye se pjesmarrësit nuk jepnin informacione që kërkonim. Gjatë verifikimit të dokumentave nuk u gjenden fatura transporti për pjesëmarrësit apo materialet e ndryshme të fushatës. Për këtë event shpenzimet më me peshë të konsiderueshme ishin të faturuara me fatura të rregullta tatimore, ku ishin të shënuara edhe me situacion përkatës në vlerë për cdo zë. Fatura e lëshuar datë 28.06.2019 në emër të Kandidatit z. Dritan Lelit, në shumën 996 000 lekë është e specifikuar me zëra analitike për shpenzimet e eventit. Kështu si shërbim skene 204 000 lekë, shërbim fonie 144 000 lekë, regji 240 000 lekë, fishekzjarre 120 000 lekë dhe ledwall 144 000 lekë. Në mitingun e mbylljes së fushatës elektorale u përdorën materiale promocionale si banera me sipërfaqe të madhe, një numer i konsiderueshëm bluza dhe kapele me logo. Ishin dërguar edhe sms promocionale për këtë event.

Pas përfundimit të fushatës zgjedhore dhe grumbullimit të informacionit, stafi i monitorimit vazhdoi komunikimet për paraqitjen e dokumentacionit të fushatës.

**Gjithsej u monitoruan 101 zyra zgjedhore në 48 Bashki të vendit, 19 aktivitete të mëdha dhe 5 takime elektorale.**



Filluam procedurat e verifikimeve dhe ballafaqimeve të shpenzimeve të konstatuara nga ana jonë. Shpenzimet e konstatuara u ballafaquan me faturat e shpenzimeve të paraqitura nga subjekti zgjedhor. Faturat e shpenzimeve i verifikuam me pagesat në llogaritë e hapura për fushatën zgjedhore, si dhe në llogaritë e Partisë Socialiste të Shqipërisë, ku ishin kryer shpenzime për fushatën. Shpenzimet për fushatën zgjedhore janë paguar nga llogaria e PS në Credins Bank, deri në momentin kur është lëvruar fondi i dhënë nga KQZ-ja, në llogarinë e çelur për fushatën zgjedhore. Fondi paradhënie prej 40,868,138 lekë është miratur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me nr.prot. 11200/1 datë 19.06.2019. Ky fond ka kaluar më datë 21.06.2019, sipas shkresës nr 11 311 të KQZ-së datë 11.06.2019, në llogarinë e hapur për fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste, Credins Bank, në llogarinë AL 94 2121 1016 0000 0000 0092 2832 në lekë.

U kontrolluan edhe shpenzimet e kandidatëve për kryetar bashkie, faturat e shpenzimeve për qeratë e zyrave zgjedhore, aktiviteteteve të organizuara, shpenzimeve administrative, etj. Këto shpenzime u krahasuan me shpenzimet e identifikuar në monitorim. Pjesë e këtij procesi ishin edhe financimet që janë bërë për Partinë Socialiste të Shqipërisë dhe për kandidatët për kryetar bashkie. Kandidati për bashkinë Maliq ka marrë një hua 7976 euro ose 974 400 lekë. Me kredinë janë paguar shpenzime për qeratë e zyrave zgjedhore, shpenzime karburanti etj.

## II Përmbledhje/Kërkesat formale

### A. Përmbledhje

1/ Identifikimi i subjektit zgjedhor në raportin e monitorimit			
a) identifikimi i subjektit zgjedhor (partia, kandidati/ja)	Po	Partia Socialiste e Shqipërisë	
b) identiteti i personit përgjegjës për financat	Po	Dhurata Isufaj	
c) evidenca e çeljes së llogarisë bankare	Po	15/05/2017	
d) paraqitja e deklarimeve bankare që mbulojnë periudhën e fushatës	Po	Nga 30.03.2019-30.09.2019	
2/ Nënshkrimi dhe data e paraqitjes së raportit të monitorimit			
Eksperti financiar	Po	Sherife Hoxha	
Nënshkrimi	Po	20.11.2019	
Dorëzimi i raportit të monitorimit	Po	21.11.2019	
3/ Aktivitetet, eventet dhe materialet e monitoruara			
a) Zyrat zgjedhore	Po	101	
b) Respektimi i ndalimit të aktiviteteteve zgjedhore edhe nga ana e bashkive.	Jo	Nuk ka	
c) aktivitetet	Po	19	
d) eventet		5	

e) materialet propagandistike (flamunj kombëtarë, banera me logo, bluza me logo të PS dhe me logo të bashkive, kapele me logo të PS)		6
--	--	---

## B. Analiza

### a. Kërkesat formale

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë ka hapur llogari për fushatën zgjedhore. Konkretisht janë hapur tre llogari bankare në Credins Bank në monedhën në Euro, USD dhe ALL si më poshtë:

- Credins Bank AL94 2121 1016 0000 0000 0092 2832 LEKE
- Credins Bank AL40 2121 1016 0000 0000 0092 2834 USD
- Credins Bank AL13 2121 1016 0000 0000 0092 2835 EUR

Në llogaritë e hapura për fushatën zgjedhore 2019 Partia Socialiste e Shqipërisë nuk ka donacione të derdhura në bankë që e kalojnë shumën mbi 100 000 lekë.

Të ardhurat e fushatës zgjedhore për Organet e Qeverisjes Vendore të 30.06.2019 janë 79,042,334 lekë. Këto të ardhura janë krijuar:

- Të ardhurat nga fondet publike 40 868 138 lekë
- Të ardhurat nga persona fizike 2,865,691 lekë
- Të ardhurat nga kontributi i kandidatëve 32,331,770 lekë
- Nga burimet e vetë partisë (kuotat) 2, 976,735 lekë.

Transaksioni nga fondet publike ka kaluar nga Ministria e Financave, në llogarinë e hapur për fushatën zgjedhore në Credins Bank, llogarinë nr. 0092 2832 lekë, më datë 21.06.2019 me shkresë nr.11311 të KQZ.

Të ardhurat nga persona fizikë janë të ardhura monetare në shumën 711, 930 lekë dhe dhurime në natyrë për vlerën 2,153,761 lekë.

Të ardhurat nga burimet e vetë partisë (kuotat e anëtarësisë) sipas degëve.

Mat	198,720
Gramsh	203,200
Kucove	259,000
Vlore	134,200
Shkoder	180,260
Pogradec	294,790
Berat	256,600
Prrrenjas	229,735

Ura vajguore	36,000
Durres	267,900
Mallakaster	183,130
Lezhe	28,000
Gjirokaster	182,400
Kruje	228,000
Sarande	294,800
<b>Totali</b>	<b>2,976,735</b>

Nga verifikimi i llogarive të kandidatëve për kryetar bashkie, disa prej tyre kanë hapur llogari për fushatën zgjedhore dhe në disa raste të tjera kandidatët kanë përdorur llogaritë e tyre personale. Kanë marrë donacione mbi 100 000 lekë kandidatët për Bashkitë Lushnjë, Vlorë, Selenicë, Librazhd, Divjakë, Fier, Rogozhinë, Korçë, Vorë, Lezhë Kukës, Gramsh, Fushë-Arrëz, Patos, Klos, Gjirokastër, Cërrik, Mat, Vau i Dejës, Mallakastër dhe Përmet.

Burimet e financimit të kandidatëve janë burimet e veta dhe donatorë të ndryshëm, për fushatën e tyre zgjedhore, të cilat në asnjë rast nuk e kanë kaluar vlerën mbi 1 milion lekë.

Financime për fushatën zgjedhore ka edhe nga persona fizikë dhe juridikë “vendas” duke kontribuar në llogaritë bankare si dhe pagesa cash me vlera më të vogla se 100 000 lekë.

Në një rast kemi financim për fushatën zgjedhore nga një kredi. Kandidati për kryetar bashkie Maliq ka marrë hua nga Union Bank për financimin e shpenzimeve. Për këtë ka një kontratë kredie e cila i plotëson kushtet e lejueshme të donacionit për fushatën.

Sipas dokumentacionit të verifikuar janë plotësuar dhe nënshkruar formularët e konfliktit të interesit për donacionet e kryera në banka dhe cash. Formularët e plotësuar kanë bashkëngjitur dokumentin e identifikimit të dhuruesve.

**Më tabelën e mëposhtme, po paraqesim listën e donatorëve për kandidatët për kryetar bashkie për zgjedhjet vendore të 30.06.2019.**

Kandidatet	Emri, Mbiem I donat.	SHA,Pers.Juridik/PF,	Vlera	Data	Llog bankare fushate	emertimi I bankes
Lushnje	Niklovan Cela	Person fizik	500,000	14.06.2019	1000-631622-001	Tirana bank
Lushnje	Ilir Badulla	Person Juridik	500,000	17.06.2019	1000-631622-001	Tirana bank
Lushnje	Ergest Krakulli	Person fizik	100,000	17.06.2019	1000-631622-001	Tirana bank
Lushnje	Flamur Peqini	Person fizik	100,000	17.06.2019	1000-631622-001	Tirana bank
Lushnje	Nertila Nushi	Person fizik	100,000	17.06.2019	1000-631622-001	Tirana bank
Lushnje	Teuta Korreshi	Person fizik	100,000	17.06.2019	1000-631622-001	Tirana bank

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

Vlore	Kristi Leli	Person Juridik	1,000,000	28.06.2019	501228005	BKT
Vlore	Dritan Leli	Individ	1,000,000	01.07.2019	501228005	BKT
Vlore	Alban Peza	SHA	500,000	20.06.2019	501228005	BKT
Selenice	Pellumd Binaj	Person Fizik	350,000	29.05.2019	0090528ë5	Raifaissen
Selenice	Danize Binaj	Person Fizik	100,000	29.05.2020	0090528ë6	Raifaissen
Librazhd	Refat Bici	Person Fizik	100,000	24.06.2019	902425103015573000	Alfa Bank
Librazhd	Petrit Lika	Person Fizik	200,000	25.06.2019	902425103015573000	Alfa Bank
Librazhd	Endri Cerma	Person Fizik	250,000	25.06.2019	902425103015573000	Alfa Bank
Librazhd	Refat Kaca	Person Fizik	200,000	24.06.2019	902425103015573000	Alfa Bank
Divjake	Fredi kokoneshi	Person Fizik	200,000	17.06.2019	0090381260	Raifaissen
Divjake	Elton Biti	person juridik	150,000	01.07.2019	0090381260	Raifaissen
Divjake	Ervis Llapaj	person juridik	150,000	28.06.2019	0090381260	Raifaissen
Divjake	Fatos Lico	person juridik	150,000	14.06.2019	0090381260	Raifaissen
Divjake	Gentian Buli	person juridik	249,750	17.06.2019	0090381260	Raifaissen
Divjake	Ilia Dhamo	person juridik	100,000	14.06.2019	0090381260	Raifaissen
Divjake	Lefter Rrudho	person juridik	150,000	14.06.2019	0090381260	Raifaissen
Fier	Anio Oil &Gaz	SHA	500,000	24.06.2019	20563111	Raifaissen
Fier	Armano Subashi	Person fizik	500,000	05.06.2019	20563111	Raifaissen
Fier	Ervin Luzi	Person fizik	500,000	25.06.2019	20563111	Raifaissen
Rrogozhine	Klement Xhyra	Individ	250,250		21416204	Union bank
Korce	Sotiraq Filo	Individ	700,000	21.06.2019	90063511	Raifaissen
Vore	Agim Kajmaku	person fizik	500,000	11.06.2019	2000-285163-002	Tirana Bank
Vore	Agim Kajmaku	person fizik	105,000	02.07.2019	2000-285163-002	Tirana Bank
Lezhe	Ervis Tushaj	person fizik	100,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank
Lezhe	Kujtim Preci	person fizik	160,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank
Lezhe	Mark Gjoka	person fizik	100,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank
Lezhe	Petrit Mhillaj	person fizik	200,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank
Lezhe	Bledar Perlika	person fizik	100,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank
Lezhe	Petrit Peci	person fizik	300,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank
Lezhe	Albert Ndreu	person fizik	200,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank
Lezhe	Pjerin Ndreu	person fizik	200,000	06.06.2019	C100001219556	Credins bank

Raport i monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjen vendore, te 30.06.2019  
Per subjektin zgjedhor: Partia Socialiste e Shqipërisë

Kukes	Lindi-Al	Person Juridik	1,000,000	13.06.2019	110FH11191640068	Union Bank
Kukes	Dorian Ramollari	person fizik	600,000	17.06.2019	550FTRQ191680003	Union Bank
Kukes	Safet Gjici	person fizik	999,500	21.06.2019	0000 0089 2321	Credis Bank
Gramsh	Klodian Tace	person fizik	371,500	07.04.2019	436000160	BKT
Fushe Arrez	Fran tuci	person fizik	406,502	ska	0090682667	Raifaissen
Patos	Rajmonda Balilaj	person fizik	500,000	18.06.2019	0001511911	Raifaissen
Klos	Ilmi Hoxha	person fizik	400,000	17.06.2019	00001774295	OTP Bank
Klos	Shefki Doma	person juridik	300,000	04.07.2019	00001774295	OTP Bank
Gjirokaster	Flamur Golemi	person fizik	500,000	10.06.2019	260477723	BKT
Cerrik	Gezim salla	person fizik	292,800	29.05.2019	00001774436	OTP Bank
Mat	Agron Malaj	person fizik	1,000,000	06/06/2019	858015	American Bank
Vau I Dejes	Aldi Ndoci	person fizik	180,000	16/08/2019	2121439	American Bank
Mallakaster	Qerim Ismailaj	person fizik	110,000	31/07/2019	1219994	Credins bank
Permet	Adriatik Qamo	person fizik	200,000	19/06/2019	1900-202191-002	Tirana bank
<b>TOTALI</b>			<b>17,525,302</b>			

Nga verifikimi i listës së donacioneve në bankë, për kandidatin **Agim Kajmaku** nuk kishte transfertë bankare për vlerën 250 750 lekë datë 16.07.2019 e raportuar në deklaratimet e kandidatit.

Llogaritë bankare për fushatën zgjedhore të vitit 2019 janë hapur më 15.05.2017. Personi përgjegjës i financave për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë është znj. Dhurata Isufaj.

## PROÇEDURA VERIFIKIMI

Rasti i bashkisë Librazhd u verifikua pas raportimit dhe plotësimit gabim nga ana jonë dhe u arrit në përfundim se në bashkinë Librazhd, **zyra e përdorur si zyre elektorale është në përdorim të Partisë Socialiste sipas një Vendimi të Këshillit të Ministrave nr 1086 datë 28.10.2009 për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Librazhd, të Qarkut Elbasan.**

Me palët e treta, si furnitorët për shërbimet e kryera në funksion të fushatës zgjedhore të 30.06.2019, nuk kishim një komunikim eficient. Ne iu dretjuam, me e-mail dhe me telefon disa furnitorëve në lidhje me çmimet e shërbimeve të ofruara prej tyre, por nuk morëm përgjigje.

Nuk kishim raste të denoncimeve dhe ankesa të mbërritura në KQZ të vëna në dijeni ekspertit financiar.

Sherife HOXHA

Audituese Ligjore



Tiranë 20.11.2019

## Shënime :

1. Data e zgjedhjeve 30 Qershor 2019

2. Periudha e përfshirë në raportin e monitorimit është 3 muaj para dhe pas ditës së zgjedhjeve sipas përcaktimit në Udhëzimin e KQZ Nr.2 datë 01.06.2017, Neni 3, Germa f (monitorim në mënyrë specifike për transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve).

3. Data maksimale e raportit të monitorimit deri 26.11.2017, në zbatim të Ligjit 90/2017 datë 22.05.2017, Neni 24/4 pika 2,

"Raporti i monitorimit i paraqitet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar në vendimin e emërimit, por në çdo rast jo më vonë se 4 muaj nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve".

- Bashkangjitur raportet javore të ndermjetme të monitorimit.
- Bashkangjitur foto të aktiviteteve kryesore të fushatës zgjedhore 2019.



Mitingu i mbylljes Vlore





Mitingu i mbylljes Vlore



Aktiviteti Elbasan



Aktiviteti Elbasan



Aktiviteti Kukes



Aktiviteti Durres



Aktiviteti Tropoje



Aktiviteti i mbylljes Tirane

## **RAPORTI JAVOR I NDERMJETEM I MONITORIMIT**

**FUSHATA ZGJEDHORE PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE TE VITIT 2019**

**Drejtuar: Komisionit Qendror te Zgjedhjeve**

**Per: Subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqiperise"**

*Monitoruesi, Eksperti Financiar Sherife Hoxha*

*Periudha e Monitoruar date 01/06/2019 - 09/06/2019*

Me marrjen e misionit si eksperte financiare per monitorimin e shpenzimeve te fushates zgjedhore per Organet e Qeverisjes Vendore te vitit 2019, per subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqiperise" me vendimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve (KQZ) Nr.740, datë 31.05.2019 ne zbatim te Ligjit Nr.90/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, date 22.05.2017, menjehere fillova punen se bashku me stafin.

- Me date 01 Qershor ne kontaktuam me drejtuesit e Partise Socialiste te Shqiperise te cilet na adresuan per takim me financieren e kesaj Partie znj. Dhurata Isufaj. Pasi dorezuam kerkesen zyrtare/formale per angazhimin dhe monitorimin e shpenzimeve te fushates zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te vitit 2019, morem kontaktet e duhura dhe gjithë informacionin e nevojshem per aktivitetet e Partise Socialiste ne terren. Gjithashtu u kontaktuan me e-mail si dhe me telefon te gjithë kandidatet per kryetar Bashkie dhe kryetaret e Partise Socialiste sipas listave qe morem ne zyrat qendrore te Partise Socialiste te Shqiperise.
- Ne date 02.06.2019 2019 ne ju drejtuam me kerkese zyrtare (kerkese e derguar me poste rekomande) Kryetareve te 61 Bashkive ne vend, per te na informuar ne lidhje me adresat e sakta të zyrave elektorale per Subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqiperise", ne zbatim te kerkesave te Udhezimit te KQZ Nr. 1 date 31.05.2017.



- Ne date 03.06.2019 ne filluam monitorimin ne terren ne disa Bashki te vendit per te verifikuar dhe identifikuar vendndodhjen apo adresat e sakta te zyrave elektorale te subjektit zgjedhor, Partia Socialiste e Shqiperise.
- Gjate procesit te monitorimit gjate kesaj jave ne Bashkine Elbasan, Cerrik, Belsh, Kucove,Ura vajgurore,Kamez dhe Berat, vihet re se sapo ka filluar hapja e zyrave elektorale . Keshtu ne Bashkine Elbasan ishte hapur vetem nje zyre elektorale ne adresen Lagjja e Re , Rruga “Aqif Pasha” (foto bashkengjitur). Nga informacioni qe morem nga financierja e Partise Socialiste Elbasan Natasha Gjorga per kete zyre ka nje kontrate huaperdorje me nje individ. Zyra eshte rreth 30 m2 dhe kishte vetem disa karrike dhe nje tavoline. Ne kete Bashki jane planifikuar per te hapur dhe 5 ose 6 te tjera. Keto do te verifikon ne periudhen ne vazhdim. Ne Bashkine Berat sapo kishte nisur hapja e zyrave elektorale dhe ne dy zyra qe ne monitoruam nuk ishin vendosur as logo e PS dhe posterat apo banera.
- Po keshtu dhe ne Bashkine Belsh si zyre elektorale perdorej zyra e Partise Socialiste Belsh ne adresen Rr”31 Gushti” ne qender te Belshit,(bashkengjitur formulari i plotesuar)
- Ne Bashkine Cerrik gjithashtu eshte hapur vetem nje zyre elektorale,por zyra ishte mbyllur dhe nuk kishim mundesi te kontaktonim per nje informacion te sakte. Ne ditet ne vijim do te japim nje informacion me te sakte dhe te plote.
- Ne date 06.06.2019 ne monitoruam gjithashtu edhe aktivitetet e Partise Socialiste ne Cerrik dhe Belsh ku merrte pjese edhe kryetari i Partise Socialiste z.Edi Rama. Gjate procesit nuk kishte materialeve propogandistike te fushates zgjedhore te ndaluara (te palejuara).  
Perdoreshin vetem flamuj dhe pak bluza te veshura nga pjesmarresit ne fushate me logon e PS.Nuk kishte elemente te tjere .
- Ne vazhdimesi kemi ndjekur takimet elektorale ne zonen e Elbasanit, takime ne lagjet e qytetit, ne Bashkine Ura Vajgurore dhe ne Bashkine e Kucoves. Jane monitoruar zyra elektorale dhe aktivitetet e fushates. Gjate monitorimit ne keto bashki u kontaktua se ne Uren vajgurore ka vetem 1(nje) zyre elektorale dhe sipas informacioneve nuk do te hapej tjeter. Per kete zyre disponohej kontrate huaperdorje me afat nga 01.06.2019 deri me 30.06.2019 lidhur midis Partise Socialiste Bashkia Ura Vajgurore (huamarrese) dhe Z.Robert Memaj (huadhenes).Siperfaqja e kesaj zyre eshte 102 m2.Nuk kishte materiale te ndaluara te fushates zgjedhore.Ne kete bashki i monitorua edhe nje aktivitet i fushates, prezantimi i kantidatit te kesaj Bashkie.
- Po keshtu dhe ne Kucove eshte hapur vetem nje zyre elektorale, per te cilen na u tha se kishin nje kontarte huaperdorje por nuk na u vu ne dispozicion, me siperfaqe rreth 60 m2. U monitorua edhe aktiviteti i fushates per prezantimin e fushates.
- Ne Bashkine Kamez u krye monitorimi i dy zyrave elektorale, nje zyre ne Bulevardin Blu Pall Ana Konstruksion, dhe nje zyre tjeter ne Paskuqan (foto bashkengjitur).Keto jane zyrat e Partise Socialiste qe po perdoren si zyra elektorale sipas kontratave qe dispononin dhe ne na u paraqiten.
- Ne Bashkine Berat u be monitorimi i dy zyrave Elektorale, por akoma jo funksionale, nuk ishte postera dhe materiale te tjera, vetem disa tavolina dhe karrige.Sipas informacioneve ishin planifikuar te hapeshin 12 zyra elektorale per bashkine Berat.(bashkengjitur keni fotot e zyrave)

Ne menyre te permbledhur po paraqesim monitorimin e zyrove elektorale sipas Bashkive dhe aktivitetet e fushates zgjedhore Jane monitoruar

- **Zyra elektorale :**

Bashkia Elbasan 1 (nje)zyre Elektorale me siperfaqe rreth 30 m2

Bashkia Belsh 1(nje) Zyre Elektorale me siperfaqe rreth 95 m2

Bashkia Cerrtik 1(nje) zyre elektorale ishte e mbyllur

Bashkia Ura Vajgurore 1 (nje) zyre Elektorale me siperfaqe 102.6m2

Bashkia Kucove 1 (nje) zyre Elektorale, me siperfaqe rreth 60 m2,nga 1 zyre e planifikuar per tu hapur.

Bashkia Kamez 2 (dy) zyra Elektorale, nga 2 zyra te planifikuar per tu hapur,njera zyre rreth 80 m2 dhe tjetra 143 m2 (kane kontarta qeraje)

Bashkia Berat 2 (dy) zyra Elektorale, nga 12 zyra qe ishin planifikuar per tu hapur.

- **Aktivitete te fushates**

Mitingu i prezantimit te Kandidatit per Kryetar Bashkie Cerrrik z.Andis Salla me pjesmarrjen e z. Edi Rama

Mitingu i prezantimit te Kandidatit per Kryetar Bashkie Belsh z. Arif Tafani me pjesmarrjen e z. Edi Rama

Mitingu i prezantimit te Kandidatit per Kryetar Bashkie Ura Vajgurore z. Juliana Memaj me pjesmarrjen e z. Edi Rama

Mitingu i prezantimit te Kandidatit per Kryetar Bashkie Kucove z. Kreshnik Hajdaraj me pjesmarrjen e z. Edi Rama

Mitingu i prezantimit te Kandidatit per Kryetar Bashkie Berat z. Ervin Demo me pjesmarrjen e z. Edi Rama

Nga kerkesat e drejtuara Bashkive per adresat e sakta te zyrove elektorale, na ka ardhur pergjigje per Bashkine Ura Vajgurore, ku thuhet qe se ne territorin e Bashkise Ura vajgurore eshte nje zyre elektorale ne qender te qytetit Lagjia "18 Tetori", Rruga Dimal.

### **1. Listat e kontrollit/ Tabela e raportimit**

Listat kontrolluese (checklistat) 1-3 duhet te perdoren per regjistrimin e vzhgimeve dhe llogaritjeve / vleresimeve qe kanë të bëjnë me elementet individuale të fushatës, të cilat dorëzohen në raportet e ndërmjetme gjatë fushatës zgjedhore. Këto lista kontrolli do të perdoren per të mbledhur të dhënat dhe informacionet qe do të jepen në raportin përfundimtar të Monitorimit. Ato do të perdoren per të gjeneruar i) gjetje për raportet javore të dorëzuara në KQZ dhe ii) për të bërë një përmbledhje të konsoliduar të gjetjeve të monitorimit.

**Lista1: Zyrat elektorale**

Bashkia	Elbasan			
Adresa	Rr'Lagjia e Re" Rruga "Aqif Pasha",Kati i pare			
Data dhe koha e vëzhgimit	05/06/2019 ora 14			
Madhësia e zyrës elektorale	Rreth 30 m2			
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore")			Jo	
Ekzistenca e një kontrate qiraje / marrëveshje qiraje			Jo	U pretendua se është lidhur por e ka pronari (kontrate huapendorje)
Numri i stafit të vëzhguesve	2 (dy)			
Pajisjet e vërejtura	Karrike, tavoline			
